



07

koncertet e vjeshtës 07

koncertet e vjeshtës



DCCRM



DCCRM

Österreichische Botschaft
Tirana



WOLFGANG PANHOFFER

Beethoveniana

Wolfgang Panhofer - Violonçel
(Vjenë, Austri)

Merita Rexha Tërshana (Piano)
(Tiranë)

Beethoveniana

Wolfgang Panhofer - Violonçel
(Vjenë, Austri)

Merita Rexha Tërshana (Piano)
(Tiranë)

Wolfgang Panhofer, violonçel
(Vienë, Austri)
Merita Tërshana Rexha, piano
(Tiranë)

Programi

Beethoven, Ludwig van - Sonata Op. 5 Nr. 2 g moll
Adagio sostenuto ed espressivo, Allegro molto piu tosto presto
Rondo, Allegro

Beethoven, Ludwig van - Sonata Op. 69 Nr. 3 A Dur
Allegro, ma non tanto
Scherzo, Allegro molto
Adagio cantabile, Allegro vivace

Kalendari

Tiranë, 01.11.2007, ora 19.00 p.m.
Sala e Akademisë së Arteve

Tiranë, 02.11.2007, ora 17.00 p.m.
Teatrit "Migjeni"
Përkrahje e Z. Lorenc Mosi

Pogradec, 03.11.2007, ora 18.00 p.m.
Salla e Bibliotekës
Nën kujdesin e Z. Artan Shkëmbi
Kryetar i Bashkisë

Për këtë koncert ndihmuan:
Ambasada e Austrisë në Tiranë
Fondacioni EDS
Moving Culture
Bashkia Pogradec
Hotel Lugano, Tiranë
Restaurant "Serenata", Tiranë



PANHOFER, Wolfgang

PANHOFER, Wolfgang, ka lindur në Vienë. Kreu studimet në shkollën e lartë të muzikës në Vienë (Prof. Benesch, Prof. Herzer) dhe në Royal Northern College në Angli (Prof. Kirschbaum) me diplomë për solist. Është fitues i shumë çmimeve (Sir John Barbirolli). Kurse kualifikimi me Boris Pergameschkow, Steven Isserlis, Paul Tortelier, William Pleeth dhe Ralph Kirschbaum. Kurse për muzikë dhome me Andreas Schiff. Koncerte në Austri, Gjermani, Angli, Uells, Belgjikë, Itali, Slloveni, Finlandë, Francë, Japoni, Indi, Islandë, Danimarkë, Poloni, Hungari, Kore, Kamerun, SH.B.A, Iran, Zvicër, Slovaki dhe Turqi. Ka realizuar një numër mjaft të madh inçizimesh në radio dhe televizion (me Paul Tortelier për BBC,

GB, Eurovision me Franz Welsch Möst, për televizionin Polak me Filarmoninë e Katowitjeve etj.). Koncert i përvjetorit të Dvorak me Josef Suk në sallën Mozart të pallatit koncertor të Vjenës. Partner për muzikë dhome me Boris Pergameschkow.

Pjesëmarrje në Festivale: Carinthischer Sommer, Steirischer Herbst, Java e Festivalit vinez, Wien Modern, Boxhill Festival dhe Park Lane Group (në Southbank), Londër, Festivali Kangasniemi, Finlandë, Vjeshta e Tiranës, etj.

Ka luajtur me orkestrën vjeneze të dhamës, me simfonistët vjenzë, Philharmonia Danzig, Linzer Jeunesse Orkester, Bombay chamber Orchestra, Philharmonitë e Katowitjeve, Posen, Lodz, Adriatische Philharmonie Ancona, Orkestrën e Akademisë së Arteve, Tiranë etj.

I ftuar i përhershëm në një cikël të muzikës moderne austriake në shoqatën e muzikës, koncerte të rregullta në sallën Schubert, në shtëpinë koncerteve në Vienë. Incizime në CD.

REXHA TËRSHANA, Merita

Pianiste shqiptare. U lind në Tiranë më 30 janar të vitit 1972.

Pasi mbaron studimet në Liceun Artistik J. Misja në Tiranë në vitet 1986 - 1990, në vitet 1990 - 1994 kryen studimet e larta për piano në Akademinë e Arteve, në klasën e M. Kristidhi. Më pas kryen edhe disa kurse kualifikimi në Schleswig Halstein Musik Festival me Prof. P. Badura-Skoda (gusht 1995) dhe në Folkwang Hochschule Essen me Prof. T. Engel (dhjetor 1998). Pas mbarimit të studimeve në Akademinë e Arteve, emërohet pedagoge në Katedrën e Pianos pranë kësaj Akademie.

M. Rexha Tërshana është një ndër pianistet më aktive të jetës muzikore shqiptare bashkëkohore. Pjesëmarrëse në pathuaj të gjitha ngjarjet e rëndësishme të muzikës në Shqipëri (Festivali Vjeshta e Tiranës, Konkurse të ndryshme, etj.), ajo zotëron një repertor të gjerë me vepra të të gjitha kohrave dhe gjinive që është materializuar në dhjetra koncerte cilësore jo vetëm në Shqipëri, por edhe jashtë saj. Ndër të tjera, M. Rexha Tërshana është interpretuesja e premierave shqiptare të disa veprave bashkëkohore me të vërtetë virtuozë dhe problematike edhe për pianistë me eksperiencë shumë më të madhe, si integralja e veprave për piano të I. Xenakis, etj. Gjithashtu ka luajtur në premierë absolute edhe shumë vepra të kompozitorëve shqiptarë.

Për aktivitetin e saj, M. Rexha Tërshana është nderuar me çmime të shumta, përmendim këtu mes të tjerave çmimin I në konkursin N. Zaraq, Tiranë, 12-14 dhjetor 1994; interpretuesja më e mirë në Festivalin e Muzikës së Re Shqiptare, 21-24 maj 1996; çmim në Konkursin e Muzikës Franceze, Tiranë, 12-15 dhjetor 1997, etj.

